



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 1, datë 18.10.2013

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR MARRJEN E NISMËS PËR HARTIMIN
E PLANIT TË PËRGJITHSHËM KOMBËTAR**

Në mbështetje të nenit 5, të pikës 1 të nenit 8, nenit 26, pikës 3 dhe 4 të nenit 33, pikës 3 të nenit 35, nenit 36-39, nenit 89 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, nenit 6 të VKM-së nr. 481, datë 22.06.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Instrumenteve të Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së, nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit” nr. 3, datë 08.10.2013 “Për fillimin e procedurave për hartimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar”,

me propozimin e Ministres për Zhvillimin Urban dhe Turizmin”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Kërkesës për Marrjen e Nismës¹ për hartimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar (PPK);

¹ Kërkesa për marrjen e Nismës – sipas përkufizimit të Ligjit Nr. 10119 “Për Planifikimin e Territorit” i ndryshuar

2. Fillimin e procedurës për ngritjen e Komitetit Ndërmintor në funksion të hartimit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar.
3. Ngarkohen të gjitha autoritetet kombëtare të planifikimit, të marrin masa për të krijuar strukturat përgjegjëse në varësi të tyre, të cilat do të trajtojnë çështjet e planifikimit për sektorët që ato mbulojnë.
4. Ngarkohen të gjitha autoritetet kombëtare të planifikimit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Pjesë integrale e këtij vendimi janë:
 - a. Studimi që përcakton faktet dhe analizon problemet, të cilat argumentojnë nevojën për hartimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe parashtrojnë qëllimin kryesor të tij;
 - b. Plani i veprimeve për hartimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E K.K.T

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË
TERRITORIT**

